



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

*STATISTIKA PËR VEPRIMTARINË
GJYQËSORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE*

PËR VITIN 2025


KËRKESAT DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025 Gjykata Kushtetuese ka pasur **605 kërkesa**, nga të cilat 501 kërkesa janë paraqitur dhe regjistruar gjatë vitit 2025, si dhe 104 kërkesa janë mbartur nga viti 2024.

Në vitin 2026 do të mbarten 173 çështje. Të gjitha çështjet e mbartura janë brenda afateve të parashikuara nga Ligji Organik i Gjykatës dhe Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese

Çështjet në shqyrtim të ndara sipas fazës:

- 74 kërkesa janë në shqyrtim në seancë plenare;
- 5 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit paraprak në Mbledhje të Gjyqtarëve
- 94 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;




Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2025 ka dhënë në total **429 vendime**, 85 vendime përfundimtare dhe 344 vendime moskalimi, si dhe ka në shqyrtim ende pa vendimmarrje 173 çështje¹.



¹ Numri përgjithshëm i vendimeve dhe çështjeve në shqyrtim nuk korrespondon me numrin total të kërkesave për shkak të bashkimit/ ndarjes së kërkesave gjatë shqyrtimit.

❖ Tabelë krahasimore 2021-2025, në lidhje me kërkesat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese, si dhe vendimmarrjet e saj.




KËRKESAT E REGJISTRUARA NË GJYKATË KUSHTETUESE GJATË VITIT 2025

Më poshtë paraqesim të dhëna statistikore për kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2025, të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, si dhe objektit të kërkesës:

❖ Kërkesat e grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- ✚ 1 kërkesë është paraqitur nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë;
- ✚ 4 kërkesa janë paraqitur nga jo më pak se 1/5-a, e deputetëve;
- ✚ 2 kërkesa janë paraqitur nga partitë politike;
- ✚ 2 kërkesa janë paraqitur nga gjykata e sistemit të zakonshëm (kontroll incidental
- ✚ 7 kërkesa janë paraqitur nga organizatat;
- ✚ 485 kërkesa janë paraqitur nga individët.

Kërkesat e grupuara sipas subjekteve



❖ Kërkesat e grupuara sipas objektit:


- ✚ 20 kërkesa janë me objekt *papajtueshmërinë e ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën;*
- ✚ 7 kërkesa janë me objekt *shfuqizimin e akteve të pushtetit publik;*
- ✚ 2 kërkesa janë me objekt *shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë;*
- ✚ 1 kërkesë është me objekt *deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese;*
- ✚ 2 kërkesa janë me objekt *konflikt kompetencash;*
- ✚ 3 kërkesë janë me objekt *shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave;*
- ✚ 7 kërkesa janë me objekt *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm së bashku me papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën;*
- ✚ 377 kërkesa janë me objekt *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm;*
- ✚ 13 kërkesa janë me objekt *konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm;*
- ✚ 59 kërkesa janë me objekt *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm;*
- ✚ 10 kërkesa janë me objekt *interpretim/ korrigjim/ rishikim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.*



VENDIMET E MARRA NGA GJYKATA KUSHTETUESE GJATË VITIT 2025

Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2025 ka dhënë në total **429 vendime** si më poshtë:

- + 85 Vendime përfundimtare.
- + 28 Vendime moskalimi nga Mbledhja e Gjyqtarëve.
- + 316 Vendime moskalimi nga Kolegjet.




- ❖ Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të arsyetuara përfshirë edhe vendimet e moskalimit, të cilat janë të arsyetuara për kriteret e pranueshmërisë.

Më poshtë paraqesim në mënyrë grafike vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, dispozitivit të vendimit, si dhe mënyrës së votimit.

❖ Vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:


- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë
- ✚ 4 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga një grup deputetësh;
- ✚ 2 vendim u përkasin kërkesave të paraqitura nga gjykatat (kontroll incidental);
- ✚ 3 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga organizatat/ shoqatat;
- ✚ 74 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga individët;



❖ Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2025, të grupuara sipas objektit të kërkesës:

- ✚ 6 vendime u përkasin kërkesave me objekt, *pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën*;
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës me objekt, *konflikt kompetencash*;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt, *shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave si të papajtueshëm me Kushtetutën*;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt, *deklarim mbarim mandati të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese*;
- ✚ 56 vendime u përkasin kërkesave me objekt, *shfuqizimin e vendime të gjykatave të sistemit të zakonshëm si të papajtueshëm me Kushtetutën*;
- ✚ 3 vendime u përkasin kërkesave me objekt, *konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm*;


- ✚ 13 vendime u përkasin kërkesave me objekt, *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm si të papajtueshëm me Kushtetutën, së bashku me konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm;*
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt, *korrigjim, shpenzime gjyqësore të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.*



❖ **Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2025, të grupuara sipas dispozitivit të vendimit:**

- ✚ Për 28 vendime Gjykata ka vendosur *pranimin e kërkesës;*
- ✚ Për 33 vendime Gjykata ka vendosur *pranimin e pjesëshëm.*
- ✚ Për 23 vendime Gjykata ka vendosur *rrëzimin e kërkesës.*
- ✚ Për 1 vendim Gjykata ka vendosur *pushimin e çështjes.*


Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2025
të grupuara sipas dispozitivit



Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2025, të grupuara sipas mënyrës së votimit:

- ✚ 53 vendime janë *njësëri*;
- ✚ 28 vendime janë me *shumicë votash*;
- ✚ 4 vendim janë *pa kuorum*.

Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2025
grupuara sipas mënyrës së votimit




VENDIMET E MOSKALIMIT TË MARRA GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025 nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese janë marrë 344 vendime moskalimi.

Më poshtë paraqesim në mënyrë grafike vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, objektit të kërkesës, si dhe Kolegjeve e Mbledhjes së Gjyqtarëve.

❖ Vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:


- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga gjykatat (kontroll incidental).
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës së paraqitur nga partitë politike.
- ✚ 4 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga shoqatat.
- ✚ 337 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga individët.



❖ Vendime moskalimi të grupuara sipas objektit të kërkesës:

- ✚ 17 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për *papajtueshmëri të ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën*;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për *shfuqizim vendimesh të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm si të papajtueshëm me Kushtetutën, së bashku me papajtueshmëri të ligjeve (apo dispozitave të veçanta të tyre) me Kushtetutën*;
- ✚ 276 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave si të papajtueshëm me Kushtetutën*;


- ✚ 17 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për *konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 24 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave si të papajtueshëm me Kushtetutën, së bashku me konstatim të cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 8 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura për *interpretimin/korrigjimin/rishikimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*.



❖ **Vendime moskalimi të marra nga Kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve:**

- ✚ 316 vendime janë marrë nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 28 janë marrë nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Vendime moskalimi të marra nga Kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve



Janar 2026